

VENDIM
Nr. 122, datë 20.10.2020

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME KUKËS SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102), të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, (VKM-së nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 20.10.2020, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a., për licencim

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kukës (UK Kukës) me shkresën nr. 397 prot., datë 1.9.2020, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesë për licencim, për shkak të mbarimit të afatit të UK Kukës, në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM-ja nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) UK Kukës ka përditësuar ekstraktin e regjistrit tregtar për shkak të riorganizimit të shoqërisë, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 63;

b) Shoqëria UK Kukës ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 35 845 banorë në Bashkinë Kukës;

c) Drejtuesja teknike e shoqërisë UK Kukës sh.a. plotëson kërkesat e VKM-së nr. 958, mbi edukimin dhe eksperiencën në profesion.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Kukës, të:

a) Kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale; aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës; përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca; si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) Kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

5. ERRU-ja, në bazë të vlerësimit dhe të verifikimeve të kërkesës së shoqërisë UK Kukës rekomandon:

- Shoqëria UK Kukës duhet të aplikojë pranë ERRU-së për miratimin e tarifave të largimit të ujërave të ndotura për të gjithë zonën e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Kukës është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a., me NUIS: J67902228S, në kategoritë:
 - a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
 - b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.
2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:
 - a) Drejtues ligjor – Asllan Hoxha;
 - b) Drejtuese teknike –Hazbije Onuzi.
3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a është Bashkia Kukës.
4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.
5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.
6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Kukës sh.a për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani